



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____ . _____ . 2023

VENDIM

Nr. 358, datë 06.07.2023

PËR

**CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE
TË VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU
USHTROJNË FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
DIBËR**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, Ilir Përdeda, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, çështjen gjyqësore me të pandehur: {...}; I akuzuar për kryerjen e veprës penale “Vjedhje e bankave dhe arkave të kursimit”, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentative, parashikuar nga nenet 236/2 e 22 të Kodit Penal.

**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
KUKËS**

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, Tonin Sterkaj (relator), Arbër Çela dhe Besmir Stroka, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}; Objekti: “Vjedhje me dhunë me pasojë vdekjen, në bashkëpunim; I akuzuari: {...}; Akuza: Neni 139-25 i Kodit Penal.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, Tonin Sterkaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, çështjen gjyqësore me kërkuar: Prokuroria; Objekti: “Vrasja për shkak të marëdhënieve familjare” mbetur në tentativë, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municioneve”; I pandehur: {...}; Akuza: neni 79/c-22 e 278/1 i Kodit Penal.

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM GJIROKASTËR

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, Dejvi Çelçima dhe Fatmir Ndreu, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, çështjen gjyqësore me palë: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor; Të pandehur: {...}, {...}.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, Dejvi Çelçima, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, çështjen gjyqësore me palë: {...}; Të pandehur: {...}.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, Fatmir Ndreu, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, çështjen gjyqësore me Paditës : {...}; I paditur: {...}, etj; Person i tretë: {...}; Objekti: Shpallje e pavlefshme absolutisht.

GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Esmeralda Xhili dhe Petrit Çomo, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}; i akuzuar për veprën penale të parashikuara nga nenet: 283/1, 333/a/2, 334/1, të Kodit Penal.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, Entela Shedula, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}, {...}, etj; Të akuzuar për veprën penale të parashikuara në nenet 248-25, 259, 245, 143/3, 144/a-25 të Kodit Penal.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, Aurel Arapi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}, {...}, {...}, {...}, {...}, {...}; të akuzuar për veprën penale të parashikuara në nenet: 283/1, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal.

4. Gjyqtari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, Aurel Arapi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}dhe {...}; të akuzuar për vepren penale të parashikuar nga nenet: 283/1, 333/a/2, 334/1, të Kodit Penal.

II. Një kopje e vendimit t'i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR